




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (DKRS)

10 / 2019 – zyrtare

Date: 05.03.2019

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në bazë të rregullores 04/2017 mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neni 8 paragrafi 3.2, shpall këtë :

THIRRJE PUBLIKE

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ju njofton se ka bërë hapjen e Thirrjes Publike për subvencionimin e OJQ-ve, të publikuar me datë: 05.03.2019, me titull:

- a. Të gjitha OJQ-të në Komunën e Gjakovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Kulturës.
- b. Të gjitha OJQ-të, Klubet Aktive Sportive në Komunën e Gjakovës programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e Sportit.

DKRS, fton të gjithë të interesuarit të cilët dëshirojnë të jenë pjesë e Komisionit Vlerësues, si ekspert të jashtëm ose përfaqësues të OJQ-ve, që të aplikojnë të jenë pjesë e komisionit.

Kandidatët e interesuar, duhen t'i plotësojnë këto kriteret, të cilat ndikojnë në përzgjedhje si më poshtë:

1. Përvoja në përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të financuara nga burimet publike (20 pikë),
2. Përvoja në vlerësimin e kërkesave të paraqitura në thirrjet për mbështetje financiare nga burimet publike (10 pikë).
3. Njohja e dokumenteve strategjike dhe politikave prioritare në fushën e thirrjes publike (15 pikë).
4. Njohja e bazës ligjore në fuqi në fushat që mbulon thirrja publike (10 pikë).
5. Njohja e metodologjive ekzistuese sektoriale në fushën e thirrjes publike (20 pikë).
6. Njohja e dokumenteve të tjera relevante në fushën në të cilën është hapur thirrja publike (10 pikë)
7. Njohja e gjuhës së institucioneve kryesore dhe qëllimit të tyre të punës në fushat në të cilat është hapur thirrja publike (15 pikë).

Afati i aplikimit është shtatë ditë kalendrike 05.03.2019 deri 13.03.2019

Dokumentet e kërkuara: Diploma mbi kualifikimin e noterizuar, Diplomat e lëshura nga Institucionet shkollore jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara (kopje); Vërtetimi për përvojën e punës (kopje); Certifikata që nuk jeni nën hetim (origjinal); Dokumenti i identifikimit (kopje). Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në adresën: Rr. "UÇK" p.n. 50000 Gjakovë, Republika e Kosovës / Zyra e DKRS-së në Pallatin e Kulturës "Asim Vokshi".

Me respekt!

Saranda Hymeri

KOMUNA E GJAKOVËS

DREJTORIA E KULTURËS RINISË DHE SPORTIT

Postal address: Nëna Terezë – Gjakovë, Kosovë / 50000 Tel: +381 390 322 591
kk.rks-gov.net/gjakove/

